



Universiteti i Prizrenit “Ukshin Hoti”

FAKULTETI I FILOLOGJISË

PROGRAMET STUDIMORE:

GJUHË DHE LETËRSI SHQIPE
GJUHË DHE LETËRSI ANGLEZE
GJUHË DHE LETËRSI GJERMANE

DORACAK

Tetor, 2021



HISTORIKU I FAKULTETIT TË FILOLOGJISË

Fakulteti i Filologjisë u themelua në vitin 2014.

Aktualisht, në Fakultetin e Filologjisë studiojnë 2632 studentë të regjistruar që nga fillimi i punës, në vitin të parë akademik (2014/15).

Fakultetit i Filologjisë organizon programet për studime në nivelin bachelor. Brenda një periudhe të afërme planifikon të hapë programin e studimeve master.

Programet e studimeve në nivelin bachelor:

- Gjuhë dhe Letërsi Shqipe
- Gjuhë dhe Letërsi Angleze
- Gjuhë dhe Letërsi Gjermane

Kërkimet shkencore dhe rezultatet e stafit akademik maten me plasimin e punimeve shkencore në revista ndërkombëtare të indeksuara në platformat e publikuara sipas Udhëzimit Administrativ të Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë të Republikës së Kosovës.

Infrastruktura e Fakultetit të Filologjisë

Fakulteti i Filologjisë aktivitetin e tij akademik e zhvillon në objektin e ish Shkollës së Lartë Pedagogjike, më vonë Fakulteti i Edukimit dega në Prizren dhe aktualisht është objekti i përbashkët me Fakultetin e Edukimit të Universitetit të Prizrenit. Fakulteti i Filologjisë ka 8 klasë-dhoma mësimi të pajisura me video-projektorë, 5 zyra të personelit akademik, 3 zyra të administratës, një sallë të përbashkët të mbledhjeve dhe amfiteatrin e përbashkët me Fakultetin e Edukimit. Ka bibliotekën (e Universitetit), të përbashkët për të gjitha njësitë akademike.

Sallat me mjete për ushtrime dhe praktikë (gjermanisht, anglisht):

1. THEMELET E PLANIT STRATEGJIK

1.1. Misioni

Misioni i Fakultetit të Filologjisë të Universitetit “UKSHIN HOTP” është rekrutimi, zhvillimi dhe edukimi dhe diplomimi i studentëve, të suksesshëm në tregun e punës në Kosovë, në rajon dhe më gjerë, për t’i

kontribuar ngritjes së mirëqenies, arsimit dhe kërkimit shkencor të cilësisë së lartë, me mundësi të barabarta për të gjithë, në pajtim me vlerat e lirisë, demokracisë dhe të diversitetit.

1.2. Vizioni

Përgatitja e studentëve të Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe, Angleze dhe Gjermane për mësimdhënës dhe për studime të mëtejme shkencore, Përvetësimi i strategjive të Procesit të Bolonjës, që kanë për qëllim aftësimin e studentëve brenda sistemit të studimit dhe aftësimin të tyre gjuhësor e komunikativ për tregun e punës dhe integrimin në hapësirën evropiane të arsimit të lartë, ku dija dhe kërkimi shkencor janë në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm kulturor, shoqëror dhe ekonomik.

1.3. Vlerat

Vlerat e Fakultetit të Filologjisë janë: mësimi sistemor i tri gjuhëve, shqipe, angleze dhe gjermane, i letërsisë shqipe, angloamerikane dhe gjermane. Mësimi me standarde evropiane të arsimit të lartë: programe me objektiva, përfshirë rezultatet mësimore të synuara; programe inkurajuese për studentët që të kenë rol aktiv në procesin mësimor; bashkëpunimi me partnerë, mobilitetiti; Punësimi i studentëve dhe të diplomuarve, e sidomos ofertat për punësim në gjuhën gjermane dhe angleze.

1.4. Palët e interesit

Palët e interesit të Fakultetit të Filologjisë janë:

Të brendshme: stafi akademik; stafi administrativ dhe teknik; menaxhmenti i njësisë akademike.

Të jashtme: studentët; alumni (studentët e diplomuar); shoqëria civile (OJQ); komuniteti shkollor; komuniteti shkencor; institucionet qeveritare lokale, nacionale e ndërkombëtare: (ÖAD, DAAD; FIBAA, DIMOS, etj.), Universiteti i Tiranës, Universiteti i Prishtinës, Universiteti i Vienës, Universiteti i Innsbruck-ut, Universiteti i Regensburg-ut, Universiteti i Graz-it; agjencitë e ndryshme.

Kampusi i UUHP





BIBLIOTEKA E UNIVERSITETIT



FAKULTETI I FILOLOGJISË
PROGRAMI:
GJUHË DHE LETËRSI SHQIPE





UNIVERSITETI I PRIZRENIT

FAKULTETI I FILOLOGJISË

PROGRAMI I GJUHËS DHE LETËRSISË SHQIPE

Programi i Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe i Fakultetit të Filologjisë në Universitetin e Prizrenit "Ukshin Hoti", është krijuar për të përmbushur nevojat e tregut të punës dhe për të përmbushur trendet e zhvillimit. Sot, një zotërim i mirë i gjuhës shqipe është i domosdoshëm për pothuajse çdo punë në vendin tonë. Programi ynë adreson nevojën e rritur për mësimdhënës të gjuhës shqipe standarde, aftësimin për punë administrative dhe nevojën për përkthyes shumë të zotë.

Komponentët kryesorë të fushës lëndore të programit përbëhen nga gjuhësia (struktura e gjuhës), gjuhësia teorike, letërsia e shkruar në shqip, historia e gjuhës, historia e letërsisë, interpretimi i letërsisë, historia dhe kultura shqiptare, qytetërimi shqiptar, konceptet dhe metodat kërkimore të gjuhësisë dhe letërsisë, teoria dhe praktika e përkthimit, analiza e ligjërimit, metodologjia e mësimdhënies së gjuhës dhe letërsisë shqipe, teroritë e të nxëniet të gjuhës, etj.

Departamenti i Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe gjithashtu ofron kurse në metodologjinë e mësimdhënies së gjuhës dhe organizon mësimdhënie praktike në shkollë, duke përmbushur kërkesat e tregut të punës për mësimdhënës të gjuhës dhe letërsisë shqipe në shkollat fillore, të mesme të ulta dhe të mesme të larta.

Qëllimet mësimore të këtij programi janë:

- Prezantimi dhe njohja e studentëve në programin e gjuhës shqipe me njohuritë e nevojshme për komunikim efektiv në;
- Njohja e studentëve me kulturën, historinë, gjuhën dhe letërsinë e shqipe të vendeve ku mësohet dhe studiohet gjuha dhe letërsia shqipe;
- Përgatitja për ata që planifikojnë të vazhdojnë studimet e tyre të gjuhës në programe pasuniversitare dhe për ata që planifikojnë të angazhohen në shumë fusha profesionale që kërkojnë njohuri të gjuhës dhe letërsisë shqipe;
- Njohuri teorike dhe praktike të gjuhësisë së aplikuar në gjuhën shqipe;
- Aftësi për të përdorur metoda dhe teknika moderne në mësimin e gjuhës standarde shqipe;
- Aftësi për të kryer kërkime të pavarura dhe në grup;
- Aftësi për të shkruar dhe folur në mënyrë akademike;
- Aftësi për të hartuar dhe kryer një studim kërkimor që kulmon në një tezë / disertacion të shkruar;
- Demonstrimi i njohurive të thelluara të aspekteve komplekse gjuhësore;
- Aftësi për të analizuar materiale komplekse;
- Aftësi për të lexuar në mënyrë kritike dhe për të shkruar në mënyrë krijuese.

Përmbajtja e procesit arsimor

Programi i studimit është i unifikuar me standardet evropiane për sa i përket kushteve të regjistrimit, kohëzgjatjes së studimit, kushteve për përfundimin e vitit të studimit, marrjes së diplomës dhe mënyrës së

studimit - Universiteti i Prishtinës, Universiteti te Tiranes, Universiteti te Korces etj.

Programi i studimit Bachelor në Gjuhë dhe Letërsi Shqipe, është në përputhje me Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve dhe Kornizën e Kualifikimeve të Zonës Evropiane të Arsimit të Lartë, nga:

- Programi Bachelor ka 240 ECTS kredi;
- Studentët kanë mundësi të zhvillojnë më tej aftësitë e tyre gjuhësore;
- Studentët kanë mundësinë të zhvillojnë aftësitë prezantuese përmes projekteve dhe seminareve dhe kështu të jenë në gjendje të paraqesin punën e tyre qartë si për audiencat e specializuara ashtu edhe për audiencat e tjera.

Lëndët brenda kurrikulës së programit të studimit janë hartuar në një mënyrë logjike dhe kronologjike për të ndihmuar studentët në zhvillimin e kompetencave dhe aftësive të përgjithshme, si dhe specifike.

Pas përfundimit të këtij cikli studimesh, studentët do të jenë në gjendje:

- të hyjnë në tregun e punës vendas dhe me gjerë si të kualifikuar profesionalisht dhe me njohuri të përparuara;
- të veprojnë në një mjedis konkurrues;
- të zbatojnë njohuritë e tyre dhe të komunikojnë qartë dhe bindshëm për audiencat e specializuara;
- të përgatisin dhe prezantojnë artikuj, teza dhe raporte kërkimore sipas standardeve profesionale;
- të organizojnë dhe zbatojnë projekte.

Programi ofron gjithsej 55 kurse obligative plus tezën e diplomimit. 16 lëndë ofrohen si zgjedhje, nga dy lëndë zgjedhore në secilin Provimet do të kryhen përmes vlerësimit formativ dhe/apo përmbledhës, si provime të integruara, seminare, projekte, studime kërkimore / raste hulumtimi apo analize / artikuj shkencorë, prezantime, ese etj.

Mënyra e studimit është me kohë të plotë me ligjërata të ofruara gjatë dy semestrave (dimëror dhe veror) që zgjasin nga 15 javë secili (semestri dimëror nga 1 tetori në 15 janar, semestri veror nga 16 shkurt deri më 31 maj). Programi Bachelor në Gjuhë dhe Letërsi Shqipe zgjat 8 semestra. Në fund të studimeve, studenti duhet të grumbullojë 240 ECTS. Këto ECTS kredi grumbullohen nga lëndë obligative dhe zgjedhore.

Përmbajtja e programit të studimit në Gjuhën dhe Letërsinë Shqipe është e krahasueshme me programet BA të studimeve vendet e Universitetet shqiptare te Rajonit. Programi është i krahasueshëm me programet e studimit të gjuhës dhe letërsisë shqipe ne Universitetin e Prishtinës, Universitetin e Tiranës etj.

Përmbajtja e programit arsimor

Fakulteti i Filologjisë, Universiteti i Prizrenit
Programi i Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe (Baçelor)

Viti I		Semestri I			
Nr.	O/Z	Emri i lëndës	L+U	ECTS	Mësimdhënësi
1.	O	Hyrje në gjuhësi	3+1	5	
2.	O	Hyrje në shkencën e letërsisë	3+1	5	
3.	O	Praktikum i gjuhës shqipe	2+2	5	
4.	O	Fonetikë e gjuhës shqipe me fonologji -I-	2+2	5	
5.	O	Letërsi popullore	2+1	4	
6.	O	Gjuhë angleze -I-	2+1	3	
7.	Z	Kulturë dhe qytetërim shqiptar	2+0	3	
8.	Z	Histori e popullit shqiptar	2+0	3	
				30	Totali

Viti I		Semestri II			
Nr.	O/Z	Emri i lëndës	L+U	ETCS	Mësimdhënësi
1.	O	Letërsi e vjetër shqipe	3+1	5	
2.	O	Teori e letërsisë	3+2	5	
3.	O	Kulturë gjuhe	2+2	5	
4.	O	Fonetikë e gjuhës shqipe me fonologji-II-	2+2	5	
5.	O	Histori e gjuhës standarde shqipe	2+1	4	
6.	O	Gjuhë angleze -II-	2+1	3	
7.	Z	Letërsi antike	2+0	3	
8.	Z	Histori e mësimdhën. së gjuhës shqipe	2+0	3	
				30	Totali

Viti II		Semestri III			
Nr.	O/Z	Emri i lëndës	L+U	ECTS	Mësimdhënësi
1.	O	Morfologji e gjuhës shqipe -I-	3+2	6	
2.	O	Letërsi romantike shqipe -I-	3+2	6	
3.	O	Leksikologji e gjuhës shqipe -I-	2+2	5	
4.	O	Letërsi për fëmijë	3+1	5	
5.	O	Gjuhë angleze -III-	2+1	4	
6.	Z	Filologji shqiptare	2+0	4	
7.	Z	Publicistikë shqiptare	2+0	4	
				30	Totali

Viti II		Semestri IV			
Nr.	O/Z	Emri i lëndës	L+U	ECTS	Mësimdhënësi
1.	O	Morfologji e gjuhës shqipe -II-	3+2	6	
2.	O	Letërsi romantike shqipe -II-	3+2	6	
3.	O	Leksikologji e gjuhës shqipe -II-	2+2	5	
4.	O	Shkrim akademik	2+1	5	
5.	O	Gjuhë angleze -IV-	2+1	4	
6.	Z	Letërsi arbëreshe	2+0	4	
7.	Z	Psikologji	2+0	4	
				30	Totali

Viti III		Semestri V			
Nr.	O/Z	Emri i lëndës	L+U	ECTS	Mësimdhënësi
1.	O	Sintaksë e gjuhës shqipe -I-	3+2	6	
2.	O	Letërsi moderne shqipe -I-	3+2	6	
3.	O	Dialektologji e gjuhës shqipe	2+2	5	
4.	O	Letërsi e sotme shqipe -I-	3+2	5	
5.	O	Gjuhësi e përgjithshme	2+1	4	
6.	Z	Gjuhë latine	2+0	4	
7.	Z	Eseistikë	2+0	4	
				30	Totali

Viti III		Semestri VI			
Nr.	O/Z	Emri i lëndës	L+U	ECTS	Mësimdhënësi
1.	O	Sintaksë e gjuhës shqipe -II-	3+2	6	
2.	O	Letërsi moderne shqipe -II-	3+2	6	
3.	O	Letërsi e sotme shqipe -II-	3+2	5	
4.	O	Gjuhësi indoeuropiane	2+2	5	
5.	O	Fonetikë historike	2+1	4	
6.	Z	Kritikë letrare	2+0	4	
7.	Z	Drejtkrimi i gjuhës shqipe	2+0	4	
				30	Totali

Viti IV		Semestrri VII			
Nr.	O/Z	Emri i lëndës	L+U	ECTS	Mësimdhënësi
1.	O	Letërsi botërore -I-	3+2	6	
2.	O	Morfologji historike	2+2	6	
3.	O	Letërsi krahasimtare	3+2	5	
4.	O	Gjuhësi e ballkanike	2+2	5	
5.	O	Metodologji e mësimdh. së gju. e letër. me praktikë	2+1	4	
6.	Z	Të folurit në publik me shkathtësi komunikimi	2+1	4	
7.	Z	Romani shqiptar	2+0	4	
				30	Totali

Viti IV		Semestri VIII			
	O/Z	Emri i lëndës	L+U	ECTS	Mësimdhënësi
1.	O	Letërsi botërore -II-	3+2	6	
2.	O	Stilistikë e gjuhës shqipe	2+2	6	
3.	O	Sociolinguistikë	2+2	4	
4.	O	Punimi i diplomës	0	6	
5.	O	Gjuhësi gjenerative	2+1	4	
6.	Z	Psikolinguistikë	2+0	4	
7.	Z	Poezia shqipe	2+0	4	
				30	Totali

MAJ, 2021

FAKULTETI I FILOLOGJISË
PROGRAMI:
GJUHË DHE LETËRSI ANGLEZE



UNIVERSITETI I PRIZRENIT
FAKULTETI I FILOLOGJISË
PROGRAMI I GJUHËS DHE LETËRSISË ANGLEZE

Programi i Gjuhës dhe Letërsisë Angleze i Fakultetit të Filologjisë në Universitetin e Prizrenit "Ukshin Hoti", është krijuar për të përmbushur nevojat e tregut të punës dhe për të parashikuar trendet e zhvillimit. Sot, një zotërim i mirë i gjuhës angleze është i domosdoshëm për pothuajse çdo punë në vendin tonë. Programi ynë adreson nevojën e rritur për mësimdhënës të gjuhës angleze, aftësimin në anglisht për punë administrative dhe nevojën për përkthyes shumë të zotë.

Komponentët kryesorë të fushës lëndore të programit përbëhen nga gjuhësia (struktura e gjuhës), gjuhësia teorike, letërsia e shkruar në anglisht (me theks të veçantë anglo-amerikane), historia e letërsisë, interpretimi i letërsisë, historia dhe kultura e anglo-amerikane, qytetërimi amerikan, historia e gjuhës, konceptet dhe metodat kërkimore të gjuhësisë dhe letërsisë, teoria dhe praktika e përkthimit, analiza e ligjërimit, metodologjia e mësimdhënies së anglishtes si gjuhë e huaj, teroritë e të nxëniet të gjuhës, etj.

Departamenti i Gjuhës dhe Letërsisë Angleze gjithashtu ofron kurse në metodologjinë e mësimdhënies së gjuhës dhe

organizon mësimdhënie praktike në shkolla, duke përmbushur kërkesat e tregut të punës për mësimdhënës të gjuhës angleze në shkollat fillore, të mesme të ulët dhe të mesme të larta.

Qëllimet mësimore të këtij programi janë:

- Prezantimi dhe njohja e studentëve të gjuhës angleze me njohuritë e nevojshme për komunikim efektiv në një gjuhë të huaj;
- Njohja e studentëve me kulturën, historinë, gjuhën dhe letërsinë e njerëzve të vendeve anglishtfolëse;
- Përgatitja për ata që planifikojnë të vazhdojnë studimet e tyre të gjuhës në programe pasuniversitare dhe për ata që planifikojnë të angazhohen në shumë fusha profesionale që kërkojnë njohuri të një gjuhe të huaj;
- Njohuri teorike dhe praktike të gjuhësisë së aplikuar në anglisht;
- Aftësi për të përdorur metoda dhe teknika moderne në mësimin e gjuhës;
- Aftësi për kthimi;
- Aftësi për të kryer kërkime të pavarura dhe në grup;
- Aftësi për të shkruar dhe folur në mënyrë akademike;
- Aftësi për të hartuar dhe kryer një studim kërkimor që kulmon në një tezë / disertacion të shkruar;
- Demonstrimi i njohurive të thelluara të aspekteve komplekse gjuhësore;
- Aftësi për të analizuar materiale komplekse;

- Aftësi për të lexuar në mënyrë kritike dhe për të shkruar në mënyrë krijuese.

Përmbajtja e procesit arsimor

Programi i studimit është i unifikuar me standardet evropiane për sa i përket kushteve të regjistrimit, kohëzgjatjes së studimit, kushteve për përfundimin e vitit të studimit, marrjes së diplomës dhe mënyrës së studimit - Universiteti i Prishtinës, Universiteti i Zagrebit, Universiteti i Lubjanës, Universiteti i Vienës, Universiteti i Gracit dhe Universiteti i Klagenfurtit.

Programi i studimit Bachelor në Gjuhë dhe Letërsi Angleze, është në përputhje me Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve dhe Kornizën e Kualifikimeve të Zonës Evropiane të Arsimit të Lartë, nga:

- Programi Bachelor ka 240 ECTS kredi;
- Studentët kanë mundësi të zhvillojnë më tej aftësitë e tyre gjuhësore;
- Studentët kanë mundësinë të zhvillojnë aftësitë prezantuese përmes projekteve dhe seminareve dhe kështu të jenë në gjendje të paraqesin punën e tyre qartë si për audiencat e specializuara ashtu edhe për audiencat e tjera.

Lëndët brenda kurrikulës së programit të studimit janë hartuar në një mënyrë logjike dhe kronologjike për të ndihmuar studentët në zhvillimin e kompetencave dhe aftësive të përgjithshme, si dhe specifike.

Pas përfundimit të këtij cikli studimesh, studentët do të jenë në gjendje:

- të hyjnë në tregun e punës vendas dhe ndërkombëtar si të kualifikuar profesionalisht dhe me njohuri të përparuara;
- të veprojnë në një mjedis konkurrues;
- të zbatojnë njohuritë e tyre dhe të komunikojnë qartë dhe bindshëm për audiencat e specializuara;
- të përgatisin dhe prezantojnë artikuj, teza dhe raporte kërkimore sipas standardeve profesionale;
- të organizojnë dhe zbatojnë projekte.

Programi ofron gjithsej 33 kurse obligative plus tezën e diplomimit. 23 lëndë ofrohen si zgjedhje, 3 lëndë zgjedhore në semestrin III, IV, 4 lëndë zgjedhore në semestrin e V, VI dhe VII, dhe 5 lëndë zgjedhore në semestrin e VIII. Provimet do të kryhen përmes vlerësimit formativ dhe/apo përmbledhës, si provime të integruara, seminare, projekte, studime kërkimore / raste hulumtimi apo analize / artikuj shkencorë, prezantime, ese, ose module të koordinuara.

Mënyra e studimit është me kohë të plotë me ligjërata të ofruara gjatë dy semestrave (dimëror dhe veror) që zgjasin nga 15 javë secili (semestri dimëror nga 1 tetori në 15 janar, semestri veror nga 16 shkurt deri më 31 maj). Programi Bachelor në Gjuhë dhe Letërsi angleze zgjat 8 semestra. Në fund të studimeve, studenti duhet të grumbullojë 240 ECTS. Këto ECTS kredi grumbullohen nga lëndë obligative dhe zgjedhore.

Përmbajtja e programit të studimit në Gjuhën dhe Letërsinë Angleze është e krahasueshme me programet BA të studimeve Angleze si gjuhë e huaj si brenda dhe jashtë vendeve

anglofone. Programi është i krahasueshëm me programet e studimit të gjuhës angleze si gjuhë e huaj në Universitetin e Zagrebit, Universitetin e Lubjanës, Universitetin e Gracit, Universitetin e Prishtinës, Universitetin e Klagenfurtit, Universitetin e Vjenes, etj.

Programi studimor i Gjuhës dhe Letërsisë Angleze 2021

Viti I		Semestri I			
Nr.	O/Z	Lëndët	L+U	ECTS	Mësimdhënësi
1.	O	Shkathësitë e integruara I	2+8	7	
2.	O	Hyrje në gjuhësi	2+3	7	
3.	O	Hyrje në letërsinë angleze	2+2	6	
4.	O	Gjuhë shqipe I	2+2	5	
5.	O	Gjuhë e huaj I (gjermane/frenge/italiane)	2+2	5	
				30	

Viti I		Semestri II			
Nr.	O/Z	Lëndët	L+U	ECTS	Mësimdhënësi
1.	O	Shkathësitë e integruara II	2+8	7	
2.	O	Fonetikë dhe Fonologji	2+2	6	
3.	O	Shkrim akademik	2+3	7	
4.	O	Gjuhë shqipe II	2+2	5	
5.	O	Gjuhë e huaj II (gjermane/frenge/italiane)	2+2	5	
				30	

Legjenda:

O – Obligative

Z – Zgjedhore

L – Ligjërata

P – Praktikë

Viti II		Semestri III			
Nr.	O/Z	Lëndët	L+U	ECTS	Mësimdhënësi
1.	O	Gjuhësi aplikative	2+2	6	
2.	O	Të kuptuarit e poezisë	2+3	7	
3.	O	Morfologji	2+3	7	
4.	O	Histori dhe qytetërim britanik	2+2	6	
5.	Z	Shkrim kreativ	2+2	4	
6.	Z	Të kuptuarit e prozës	2+2	4	
7.	Z	Shkathësitë e studimit	2+2	4	
8.	Z	Gjuhë e huaj III (gjermane/frenge/italiane)	2+2	4	
				30	

Viti II		Semestri IV			
Nr.	O/Z	Lëndët	L+U	ECTS	Mësimdhënësi
1.	O	Sintaksë I	2+3	7	
2.	O	Poezia e renesancës	2+3	7	
3.	O	Anglishtja për qëllime të veçanta I	2+2	6	
4.	O	Histori dhe qytetërim amerikan	2+2	6	
5.	Z	Tregime të shkurta amerikane	2+2	4	
6.	Z	Hyrje në mësimdhënie dhe mësimnxënie	2+2	4	
7.	Z	Gjuhë dhe kulturë	2+2	4	
8.	Z	Gjuhë e huaj IV (gjermane/frenge/italiane)	2+2	4	
Total				30	

Viti III		Semestri V			
Nr.	O/Z	Lëndët	L+U	ECTS	Mësimdhënësi
1.	O	Sintaksë II	2+3	7	
2.	O	Mësimdhënia e gjuhës angleze me praktikë I	2+3	7	
3.	O	Shekspiri	2+2	6	
4.	O	Anglishtja për qëllime të veçanta II	2+2	6	
5.	Z	Neoklasicizmi / Letërsia e shekullit të XVIII	2+2	4	
6.	Z	Teoria e përkthimit	2+2	4	
7.	Z	Të folurit në publik dhe prezantimi	2+2	4	
8.	Z	Të nxënit e gjuhës së huaj	2+2	4	
				30	

Viti III		Semestri VI			
Nr.	O/Z	Lëndët	L+U	ECTS	Mësimdhënësi
1.	O	Mësimdhënia e gjuhës angleze me praktikë II	2+3	7	
2.	O	Anglishtja akademike	2+3	6	
3.	O	Zhvillimi i gjuhës angleze	2+3	6	
4.	O	Romanticizmi	2+3	7	
5.	Z	Variatetet e anglishtes në botë	2+2	4	
6.	Z	Përkthim anglisht-shqip	2+2	4	
7.	Z	Letërsia amerikane e shekullit XIX	2+2	4	
8.	Z	Konceptet dhe zhvillimi i kurrikulës	2+2	4	
				30	

Viti IV		Semestri VII			
Nr.	O/Z	Lëndët	L+U	ECTS	Mësimdhënësi
1.	O	Hyrje në hulumtim	2+4	7	
2.	O	Analizë e tekstit	2+2	6	
3.	O	Letërsi viktoriane	2+3	7	
4.	O	Trendet aktuale në mësimdhënie	2+2	6	
5.	Z	Planifikimi i orës mësimore	2+2	4	
6.	Z	Përkthim shqip-anglisht	2+2	4	
7.	Z	Femrat, feminizmi dhe shkrimi	2+2	4	
8.	Z	Hyrje në shumëgjuhësinë: një qasje shoqërore	2+2	4	
9.	Z	Letërsitë jo-transatlantike të vendeve anglishtfolëse	2+2	4	
				30	

Viti IV		Semestri VIII			
Nr.	O/Z	Lëndët	L+U	ECTS	Mësimdhënësi
1.	O	Praktikë në shkollë	0+6	5	
2.	O	Të nxënit e gjuhës së parë dhe të dytë	2+2	5	
3.	O	Letërsi moderne angleze	2+3	6	
4.	Z	Parimet e pedagogjisë	2+2	4	
5.	Z	Hartimi dhe vlerësimi i testeve	2+2	4	
6.	Z	Letërsi moderne amerikane	2+2	4	
7.	Z	Metodologji e mësimdhënies online	2+2	4	
8.	Z	Analizë e diskursit	2+2	4	
9.	O	Punimi i diplomës		10	
				30	

MAJ, 2021

FAKULTETI I FILOLOGJISË
PROGRAMI:
GJUHË DHE LETËRSI GJERMANE



UNIVERSITETI I PRIZRENIT
FAKULTETI I FILOLOGJISË
PROGRAMI I GJUHËS DHE LETËRSISË GJERMANE

Programi i studimeve në nivelin Bachelor “Gjuhë dhe Letërsi Gjermane” është program që ofron kualifikime në fushën e gjuhësisë dhe literaturës gjermane. Ky program është i hartuar veçanërisht për nxënësit të cilët kanë përfunduar shkollën e mesme të shkencave shoqërore dhe të cilët duan të avancojnë njohuritë dhe shkathtësitë gjuhësore jo vetëm në tregun e brendshëm por edhe në tregjet ndërkombëtare.

Ky program i studimeve të ciklit Bachelor ka për mision ofrimin e edukimit cilësor dhe ndërtimin e kapaciteteve kërkimore-shkencore të studentëve, zhvillimin e shkathtësive dhe kompetencave të tyre gjuhësore për t’u përballur me sfidat e arsimit dhe komunikimit në nivel lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar. Të diplomuarit e këtij programi studimor do të kenë të zhvilluara shkathtësitë dhe kompetencat e tyre komplementare me kërkesat e tregut të punës, si dhe do të jenë të përgjegjshëm në ofrimin e kontributit të tyre në komunitet.

Njëkohësisht, ky program studimor ka si pjesë të rëndësishme të tij, kontributin në shoqëri duke ofruar një program cilësor që zhvillon njohuri të aplikueshme për tregun e punës në Kosovë, në rajon dhe më gjerë duke zhvilluar aftësi hulumtuese të cilat do të ndihmonin arsimin në përgjithësi. Për këtë qëllim është themeluar edhe Bordi Këshillëdhënës i Filologjisë (BKF) i cili ka për qëllim të kontribuoj në hartimin e kurrikulave mësimore duke u bazuar në nevojat e tregut të punës. Po ashtu, programi studimor ka

paraparë edhe zhvillimin e vizitave studimore, nëpërmjet të cilave studentët do të kenë mundësi t'i përcjellin nga afër rrjedhat e arsimit, shkencës, kulturës, civilizimit etj, nëpër qendrat vendore e ndërkombëtare. Për këtë qëllim janë nënshkruar një varg i marrëveshjeve me akterë relevant të tregut, siç janë OeAD austriake; DAAD, DIMOS, por edhe me Asociacione të tjera nga vendet perëndimore.

Qëllimi dhe profili i programit të studimeve:

Programi i Gjuhës dhe Letërsisë Gjermane përgatit studentë për karrierë në fushë të mësuesisë dhe të përkthimit, komunikimit në gjuhën gjermane, etj.

Studentët do të ndjekin ligjëratat dhe ushtrimet të cilat kryesisht janë të fokusuar në aspektin e gjuhës, gjuhësisë, letërsisë dhe kulturës gjermane, si dhe të metodikës e didaktikës së mësimdhënies së gjermanishtes si gjuhë e huaj dhe të translato-logjisë (përkthim, interpretim).

Integrimi i programit në tregun e punës:

Stafi i rregullt akademik i degës: Gjuhë dhe Letërsi Gjermane pas konsultimeve të bëra me institucionet relevante për çështje të akreditimit (si FIBAA – agjensioni për Akreditim të Universiteteve Gjermane) është i mendimit që kërkesa për riakreditim të degës Gjuhë dhe Letërsi Gjermane të bëhet për programin 3-vjeçar (6 semestra), pasi të tre profesor të rregullt janë të fushës së gjermanistikës me tituj doktor shkence nga Universiteti i Vjenës.

Duke marrë parasysh kërkesat e tregut të punës, punësimi si mësimdhënës i gjuhës gjermane në shkollat fillore (klasat 6-9) dhe në tregun e marketingut gjerman dhe mundësinë e ofrimit të studimeve sipas programit të Bolonjës me sistem 3+2 (Bachelor +Master), ashtu si është e rregulluar edhe në Universitetin Shtetëror të Tiranës, përvojën e kaluar të Universitetit të Prishtinës, si dhe faktin se kemi kuadro të cilët janë para përfundimit të studimeve të tyre doktorate si në Universitetin e Graz-it, Vjenës, Mannheim-it, Tiranës, etj. pastaj bashkëpunimin me OEAD austriake, DAAD gjermane

dhe profesor nga Universiteti i Innsbruck-ut Prof.dr. Jörg Meier; jemi të sigurt se shpejt do të hapim edhe studimet e nivelit Master. Me këtë do të ngritet cilësia e studimeve dhe do kemi të diplomuar me titull Master, të cilët do të mund të punojnë edhe në shkollat e mesme, por edhe në kolegje private.

Objektivat e mësimit:

Gjuha & komunikimi; lexim dhe dëgjim; të shprehurit me shkrim; zhvillimi i shkathtësive të avancuara në të lexuar, të folur dhe të shkruar të gjermanishtes.

Njohuri gjuhësore deri në nivelin B2 (sidomos nga lëndët: Gjuhë Gjermane Praktike gjuhe I – VI, A2/1 – B2/2).

Pasi niveli i njohurive të gjuhës gjermane nga studentët është i ndryshëm, ata ndahen në grupe për ushtrime lektorale sipas nivelit të njohurive të gjuhës gjermane.

Linguistikë: T'i zhvillojë aftësitë e studentëve që t'i njohin përbërësit e ndryshëm leksikor që e ndërtojnë gjuhën gjermane, t'i kuptojnë vetitë sintetike komplekse, dhe të analizojnë dhe t'i reflektojnë ato në gramatikë. Fitohet dija themelore teorike për strukturën gjuhësore të gjermanishtes.

Literaturë: T'i zhvillojë aftësitë e studentëve për ta përdorur terminologjinë e duhur gjuhësore, kulturore, apo edhe analizat letrare. Të fitojnë njohuritë themelore për gjuhësinë dhe letërsinë gjermane.

Njohuri kulturore: Zhvillon diturinë e studentëve të periudhave kryesore letrare e kulturore, autorët dhe lëvizjet e letërsisë gjermane brenda kontekstit të tyre kulturor, intelektual dhe socio-politik. Njohuri të përgjithshme për kulturën dhe shoqëritë e vendeve gjermano-folëse, përkthim – interpretim, etj.

Studentët e departamentit të Gjuhës dhe Letërsisë Gjermane shkollimin e tyre e përfundojnë si kuadro me dituri efikase gjuhësore, kulturore dhe sociale në fusha të ndryshme. Derisa një numër i të diplomuarve të gjuhës gjermane do të zgjedhin të japin mësim në nivelin e shkollës fillore, të tjerët

do të ofrojnë kurse të gjuhës gjermane, ndërsa pas diplomimit në studimet Master mund të punojnë edhe në shkolla të mesme, kolegje apo edhe universitet, ndërsa një pjesë tjetër mund të punojë në Marketing-un gjerman.

Analizat tekstuale dhe aftësitë e të shkruarit do ta bëjnë në gjuhën gjermane, specializim tradicional për shumë profesione, duke përfshirë gazetarinë, drejtësinë, shkrimin teknik, shkencën e bibliotekës dhe llojlojshmërinë e fushave në biznesin botëror, si në fushën mediale, informim dhe turizëm, por gjithashtu edhe në shumë institucione publike.

Studentët do ta përfundojnë studimin e tyre si individë me dituri të lartë gjuhësore, kulturore dhe sociale në fusha të ndryshme.

Të diplomuarit mund të punojnë si administratorë, asistentë, përkthyes dhe interpretues në kompani, apo redaktorë në shtëpi botuese, etj.

Me ngritjen e zhvillimit teknologjik dhe kërkesën e zhvillimeve të reja vjen në shprehje gjithashtu nevoja për qasje në literaturën e huaj ku përkthimi i saj bëhet i rëndësishëm për zhvillimet në shumicën e veprimtarive në Kosovë.

Përveç kësaj, ata mund të punojnë gjithashtu në fushat e medieve, komunikimit, të turizmit, por edhe në institucionet e ndryshme publike.

Që nga 1999, Kosova është karakterizuar me prezencë të bashkësisë ndërkombëtare. Si rezultat, janë shumë organizata ndërkombëtare të themeluara e që ende funksionojnë në Kosovë. Në këtë mënyrë nevoja dhe kërkesa për punësim të përkthyesve në gjuhën gjermane viteve të fundit është rritur. Së pari, kjo kërkesë ka qenë më aktuale për organizatat ndërkombëtare dhe më pas fryma e rekrutimit të stafit të tillë u përhap edhe për institucionet publike kosovare të formuara rishtazi, gjithashtu edhe në institucionet tjera që janë në procesin e themelimit.

Programi i Gjuhës dhe Letërsisë Gjermane (Bachelor) i ofruar në Universitetin e Prizrenit është kombinim i ligjëratave dhe ushtrimeve gjuhësore që përgatit të diplomuar për tregun e punës. Është program me orientim konkret drejt tregut të punës, program i cili ofron lëndë të rangut të gjerë për aftësimin e studentëve me shkathtësi të nevojshme teorike dhe praktike.

Pas përfundimit të suksesshëm të studimeve Bachelor, studentin do të jetë në gjendje:

- të analizojë shprehjet gjuhësore dhe strukturat gjuhësore;
- të kuptojë një spektër të gjerë tekstesh, ndër to edhe tekste të gjata, tekste specifike komplekse, komente dhe raporte;
- të shkruajë mbi situata komplekse, duke u shprehur qartë dhe në mënyrë të strukturuar dhe duke zgjedhur gjuhën e përshtatshme për lexuesin;
- të flasë rrjedhshëm dhe spontanisht, të mbajë qëndrim, të formulojë saktë mendimet dhe idetë e tij/saj dhe t'i paraqesë ato me hollësi;
- të kryejë një punë hulumtuese;
- të përpilojë një punim shkencor sipas teknikave/rregullave për punime shkencore;
- të analizojë tekste letrare në përgjithësi;
- të demonstrojë njohuri themelore për teoritë e ndryshme linguistike dhe letrare;
- të komunikojë në gjuhën gjermane në nivel të avancuar;
- t'i identifikojë veprat e letërsisë gjermane sipas epokës letrare;
- të punojë me efekt, individualisht dhe në grup;
- të demonstrojë njohuri të thella për aspektet e ndryshme të letërsisë, historisë dhe kulturës gjermane;

- të hartojë punime seminare dhe t'i prezantojë ato me kompetencë akademike dhe teknike;
- të përpilojë tekste akademike dhe t'i prezantojë ato;
- të demonstrojë njohuri për metodat e mësimdhënies së gjermanishtes si gjuhë e huaj;
- të planifikojë dhe të mbajë orën mësimore;
- të kryej me suksese temën e diplomës;
- të dëshmojë kompetenca të mjaftueshme për t'u përfshirë në tregun e punës (në mësimdhënie, përkthim për institucione të ndryshme, projekte hulumtuese, etj.).
- të hyjnë në tregun e brendshëm dhe ndërkombëtar të punës si të kualifikuar profesionalisht dhe me njohuri të avancuara në fushën e gjuhës dhe literaturës gjermane;
- të veprojnë në mjedisin konkurrues,
- të zbatojnë njohuritë e tyre në praktikë dhe t'i komunikojnë ato në audiencë të specializuar në mënyrë të qartë dhe bindëse,
- të përgatisin dhe prezantojnë teza dhe raporte sipas standardeve profesionale,
- të udhëheqin projekte,
- të organizojnë dhe zbatojnë projekte kërkimore,
- të menaxhojnë kohën në mënyrë efektive dhe në mënyrë të pavarur,
- të ketë një numër aftësish gjuhësore dhe komunikuese,

Për çështjet procedurale dhe akademike, studentët dhe stafi akademik mund t'i referohen *Statutit të Universitetit*, i cili është publik dhe i qasshëm në webfaqen e Universitetit në vegëzën <https://uni-prizren.com/sq/statuti-i-universitetit#breadcrumb> dhe *Rregullores për përcaktimin e kriterëve të studimeve bachelor* e i cili është publik dhe i qasshëm në vegëzën

https://uni-prizren.com/repository/docs/Rregullore_Bachelor.

Kjo rregullore përcakton kriteret e studimeve që nga definimi i programit, regjistrimi i studentëve e deri tek diplomimi. Gjithashtu ekziston edhe Kodi i Etikës si dhe gjatë vitit 2019 janë krijuar edhe rregullore të tjera siç janë *Rregullorja për kërkime shkencore*, *Rregullorja për sigurimin e cilësisë*. Të gjitha këto rregullore janë të publikuara në vegëzën <https://uni-prizren.com/sq/rregulloret-dhe-dokumentet-upz#breadcrumb>

FF, pjesë e të cilës është edhe ky program studimor, ka burime të mjaftueshme akademike, administrative dhe financiare që mundësojnë zbatimin e plotë, të suksesshëm dhe të qëndrueshëm të programit. Së pari, FF posedon objektin e vet me 9 salla mësimi. Për menaxhimin e kërkesave dhe dosjeve të studentëve është përgjegjës Sekretari i FF dhe Zyrtari për shërbime të studentëve në nivelin Bachelor në FF. Ndërsa, për mbarëvajtjen e procesit mësimor dhe çështjeve të tjera akademike kujdeset Dekani i FF, Prodekani, shefat e programeve /administratorët e programit.

Administrimi i programit të studimit:

Orientimi dhe administrimi i programit të studimit bëhet sipas parimeve udhëheqëse të institucionit. Dega e Gjuhës Gjermane është në kuadër të Fakultetit të Filologjisë.

Pasqyrë e programit të studimeve Bachelor – Gjuhë dhe Letërsi Gjermane 2021

Viti I						Mësimdhënësi
Semestri I			Orë/javë			
Nr.	O/Z	Lëndët	L	U	ECTS	
1.	O	1.1 Gjuhë Gjermane I, Praktikë gjuhe (A2/1)	3	3	6	
2.	O	1.2 Gramatikë e gjuhës gjermane	2	2	5	
3.	O	1.3 Hyrje në linguistikë gjermane	2	2	5	
4.	O	1.4 Hyrje në letërsinë gjermane (në shkencën e letërsisë)	2	2	5	
5.	O	1.5 Civilizimi dhe kultura gjermane	2	0	5	
6.	O	1.6 Gjuhë shqipe I	2	2	4	
		Gjithsej – semestri I	24 orë		30	
Semestri II						Mësimdhënësi
7.	O	2.1 Gjuhë Gjermane II, Praktikë gjuhe (A2/2)	3	3	6	
8.	O	2.2 Fonetikë dhe fonologji e gjuhës gjermane	2	2	5	
9.	O	2.3 Hyrje në translatologji (përkthim dhe interpretim)	2	2	5	
10.	O	2.4 Hyrje në teknikën e punës së studimit të gjermanistikës	2	2	5	
11.	O	2.5 Gjuhë shqipe II	2	1	5	
12.	O	2.6 Gjuhë e huaj I	2	1	4	
		Gjithsej	24 orë		30	

Viti II						
Mësimdhëni						
Semestri III				Orë/javë		
Nr	O/Z	Lëndët	L	U	ECTS	
1.	O	3.1 Gjuhë Gjermane III, Praktikë gjuhe (B1/1)	2	4	5	
2.	O	3.2 Morfologji e gjuhës gjermane	2	1	5	
3.	O	3.3 Letërsi gjermane I	2	1	5	
4.	O	3.4 Hyrje në didaktikën e gjuhëve të huaja	2	1	3	
5.	O	3.5 Gjermanishtja e ekonomisë	2	1	4	
Gjithsej			18 orë		22	
Lëndë me zgjedhje						
6.	Z	3.6 Gjuhë e huaj II	2	1	4	
7.	Z	3.7 Ortografi	2	1	4	
8.	Z	3.8 Gjuhësi e tekstit	2	1	4	
9.	Z	3.9 Filozofia e arsimit	2	1	4	
Gjithsej – semestri III			24 orë		30	
Semestri IV						Mësimdhëni
10	O	4.1 Gjuhë Gjermane IV, Praktikë gjuhe (B1/2)	2	4	5	ësi
11	O	4.2 Sintaksë e gjuhës gjermane	2	1	4	
12	O	4.3 Leksikologji dhe leksikografi e gjuhës gjermane	2	1	4	
13	O	4.4 Metodika dhe didaktika e gjuhës gjermane I	2	1	5	
14	O	4.5 Letërsi gjermane II	2	1	4	
Gjithsej			18 orë		22	
Lëndë me zgjedhje						
15	Z	4.6 Komunikimi ndërkulturor	2	1	4	
16	Z	4.7 Leximi dhe kuptimi i teksteve	2	1	4	
17	Z	4.8 Analizë e gabimeve gjuhësore	2	1	4	
18	Z	4.9 Fjalëformimi i gjuhës gjermane	2	1	4	
Gjithsej – semestri IV			24 orë		30	

Viti III						Mësimdhënësi
Semestri V			Orë/javë			
Nr	Sh	Lëndët	L	U	ECTS	
1.	O	5.1 Gjuhë Gjermane V, Praktikë gjuhe (B2/1)	3	5	8	
2.	O	5.2 Metodika dhe didaktika e gjuhës gjermane II	2	2	5	
3.	O	5.3 Seminar i gjuhësisë gjermane	2	2	5	
4.	O	5.4 Gjuhësi kontrastive	2	0	4	
		Gjithsej	18		22	
Lëndë me zgjedhje						
5.	Z	5.5 Përkthim gjermanisht –shqip	2	1	4	
6.	Z	5.6 Analizat dhe përgatitja e mësimdhënies së gjermanishtes si gjuhë e huaj	2	1	4	
7.	Z	5.7 Filmi dhe teatri në shek. XX	2	1	4	
8.	Z	5.8 Letërsia në mësimdhënien e gjuhës gjermane si gjuhë e huaj	2	1	4	
Gjithsej – semestri V			24		30	
Semestri VI						Mësimdhënësi

MAJ, 2021



Universiteti i Prizrenit “Ukshin Hoti”

FAKULTETI I FILOLOGJISË

PROGRAMET STUDIMORE:

GJUHË DHE LETËRSI SHQIPE
GJUHË DHE LETËRSI ANGLEZE
GJUHË DHE LETËRSI GJERMANE

DORACAK

Tetor, 2021